



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. 477/ Prot

Tiranë, më 26/02/2024

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

**DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT
DHE AFTËSIVE, FIER**

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr.164, datë 05.10.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës” dhe shkresës me nr.162 prot, datë 21.02.2024 “Njoftim për vend pune” të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Fier, protokolluar në AKPA me nr.477 prot, datë 22.02.2024, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në faqen elektronike zyrtare të AKPA-s, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Fier, brenda datës 26.02.2024, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

Specialist në Sektorin e Menaxhimit dhe Ofrimit të Shërbimeve të Punësimit, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Fier,

1. Kriteria të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

2. Kriteria të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare “Bachelor”.
- b) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit.
- c) njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

3. Dokumentet e aplikimit:

- a. letërmotivimi për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës”;
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën dhe listën e notave;
- e. librezën e punës (nëse ka eksperiencë pune);
- f. çdo dokumentacion tjetër, që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (nëse ka);
- g. certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetim nga punëdhënësi i fundit,që nuk ka masë disiplinore në fuqi (nëse ka eksperiencë pune);
- k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm (nëse ka eksperiencë punë).

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, si dhe të jenë të noterizuara.

Njoftimi bëhet në faqen elektronike zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Fier.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-s, brenda datës 06.03.2024.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

Struktura e vlerësimit të kandidatëve fitues në fazën e dytë zhvillohet si më poshtë:

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë i ndarë në:
 - i. arsimimi: 20 pikë;
 - ii. njohuritë në fushën e TIK- ut: 20 pikë;
 - Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë;
 - Komisioni për intervistën e strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh të bazuara në kompetenca, për të gjithë kandidatët.
 - Në intervistë, ndër të tjerat, kandidati vlerësohet për:
 - a. Ligji nr.15/2019 "Per nxitjen e punesimit";
 - b. VKM nr.17, date 15.01.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale"; i ndryshuar;
 - c. VKM nr.348, datë 29.04.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit";
 - d. VKM nr.535, date 08.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet";
 - e. VKM nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", i ndryshuar;
 - f. VKM nr.161, datë 21.03.2018 "Për pagesën e së ardhurës nga papunësia";
 - g. VKM nr.837, date 28.10.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit" i ndryshuar;
 - ii. motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;
- Komisioni mbledh pikët dhe liston kandidatët sipas pikëve.
Minimumi i pikëve për t'u kualifikuar është 70 pikë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

